



KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
VENDIM

Nr. 98 , Dt. 18 / 10 / 2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.
51, DT. 19.07.2007, "RREGULLORJA E QARKULLIMIT TË
AUTOMJETEVE DHE MJETEVE TË TJERA NË QYTETIN E
KORÇËS"

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit "Për disa shtesa në vendim e Këshillit Bashkiak Korçë nr. 51, dt. 19.7.2007, 'Rregullorja e qarkullimit të automjeteve dhe mjeteve të tjera në qytetin e Korçës", mbështetur në ligjin nr. 8378, dt. 22.07.1998, "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 2 dhe neni 7; ligjin nr. 8308, date 18.3.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 35; ligjin 8485, dt. 12.5.1999, "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 124; ligjin nr. 8652, dt. 31.7.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, neni 32;

VENDOSI :

1.Në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 51, dt. 19.7.2007, "Rregullorja e qarkullimit të automjeteve dhe mjeteve të tjera në qytetin e Korçës", bëhen këto shtesa:

Pas pikës 7, shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje:

"Ndalohet qarkullimi i autoveturave taksi me (8+1) vende të cilat nuk janë të liçencuara prej Bashkisë Korçë në rrugën "Midhi Kostani", "Kiço Greço" dhe në sheshin "Korça".

Pas pikës 12, shtohet pika 13 me këtë përmbajtje:

"Vendqëndrimi i autoveturave taksi me (8+1) vende të Bashkisë Korçë do të jetë përgjatë rrugës pranë daljes nga ish-Trikotazhi, me sens në drejtim të daljes nga qyteti i Korçës. Numri i vendeve të parkimit në këtë vendqëndrim do të jetë 15.

2. Te shfuqizojë vendimin nr. 41, dt. 8.6.2005, të Këshillit Bashkiak Korçë “Mbi vendqëndrimet taksi”.

3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Drejtoria e Policisë Bashkiake.

4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARI
Gjergji PENDAVINJI

